



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Kuvendi i Komunës

Nr. 02/259

Datë: 19.04.2019

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika d, nenit 17 pika f, nenit 40, të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28/15, qershor 2008), nenit 10 paragrafi 1 pika f, nenit 19, të Statutit të Komunës së Malishevës nr. 01/871 të datës 12.11.2008, Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e -IV- (katërt) të mbajtur me datën:12.04.2019 miraton këto:

REKOMANDIME

1. Në projektet të cilat i zhvillon Komuna për kanalizimet të përfshihet në procesin e pranimit dhe monitorimit edhe njësia Hidroregjioni në Malishevë ashtu siç është e paraparë me Ligj dhe me përgjegjësitë që i takojnë Hidroregjionit në mënyrë që të sigurohet një kalim i përgjegjësive ose i projektit nga Komuna tek njësia Hidroregjioni.
2. Njësia Hidroregjioni brenda nja afati kohor t'i sjellë raport Kuvendit të Komunës mbi gjendjen dhe cilësinë e ujit, mbi gjendjen e infrastrukturës dhe problemet që janë në ketë drejtim.
3. Njësia Hidroregjioni në bashkëpunim me Komunën të bëjnë menjëherë matjet e 5 puseve në të njëjtën kohë në fshatin Senik lidhur me kapacitetin e ujit.
4. Njësia Hidroregjioni në bashkëpunim me Komunën t'i adresoj sa më shpejt shqetësimet e qytetarëve edhe të Kuvendit për nivelin dhe cilësinë e furnizimit me ujë të fshatrave të cilat Hidroregjioni i ka në menaxhim.

Rekomandimet ju dërgohen:

MAPL-së

Njesisë Hidroregjioni

Drejtoria Komunale

Arkivit të Komunës.

